



UNIVERSITY OF MITROVICA

"ISA BOLETINI"

Rr. Ukshin Kovaqica, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës

<http://www.umib.net>; Tel: +383-28535725/535727

RAPORT VLERËSUES

**Nga Procesi i Monitorimit të Planit Strategjik të UMIB,
për Periudhën Janar – Shtator 2019**

Mitrovicë, Tetor 2019

PËRMBAJTJA

1. HYRJE	4
2. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	5
3. METODOLOGJIA.....	6
4. PROGRESI I ARRITUR SIPAS OBJEKTIVAVE	7
Objektivi Strategjik 1: Mësimdhënia, kërkimi & shërbimi	7
Objektivi Strategjik 2: Zhvillimi i shërbimit ndaj studentëve	11
Objektivi Strategjik 3: Akreditimi dhe kontrolli i cilësisë	13
Objektivi Strategjik 4. Nivele/ Programe të kërkua nga tregu	22
Objektivi Strategjik 5: Burimet njerëzore	24
Objektivi strategjik 6: Zhvillimi i sistemit për informim publik	26
Objektivi Strategjik 7: Zhvillimi dhe menaxhimi i burimeve financiare (resurseve).....	29
Objektivi Strategjik 8: Globalizimi/Ndërkombtarizimi....	Error! Bookmark not defined.
5. STATUSI I ZBATIMIT TË AKTIVITETEVE	36
6. ZBATIMI SIPAS OBJEKTIVAVE STRATEGJIKE.....	Error! Bookmark not defined.
7. REKOMANDIME	Error! Bookmark not defined.

SHKURTESAT

KD	Këshilli Drejtues
KP	Komisioni profesional
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
NJA	Njësitë Akademike
PA	Parlamenti Studentor
PSUMIB	Plani Strategjik i Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini”
SA	Stafi akademik
SI	Sistemi informativ
TI	Teknologjia informative
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe e Komunikimit
UMIB	Universiteti i Mitrovicës “Isa Boletini”
ZIKP	Zyra për Informim dhe Komunikim me Publikun
ZSC	Zyra për Sigurim të Cilësisë

1. HYRJE

Plani Strategjik i UMIB 2018-2021, ishte përpiluar mbështetur në dokumentet dhe në raportet për gjendjen e fakulteteve të trashëguara si dhe atyre të reja, të organizuara në kuadër të Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini”. Përmbajtja e PSUMIB ishte hartuar në përputhje me dokumentet politike të përmendura më poshtë, si rrjedhim edhe objektivat strategjike të planit strategjik për vitet 2018-2021, kanë korresponduar me objektivat e dokumenteve politike dhe strategjive nacionale. Strategjinë Kombëtare për Zhvillim 2016-2021 të Qeverisë së Kosovës; Ligji për Arsimin e Lartë i Republikës së Kosovës, 2010; Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021; Statuti i Përkohshëm i UMIB-it;

Këshilli Drejtues i UMIB-it në mbledhjen e mbajtur me datën 28.09.2017, me vendimin numër 1307/005, komisionin profesional për hartimin e planit strategjik i cili ishte i përbërë prej 5 anëtarësh.

Në të njëjtën mbledhje u miratua edhe grupi për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të planit strategjik, i cili në periudhën 6 mujore pas aprovimit të planit strategjik nga Këshilli Drejtues i UMIB-it, ka filluar detyrën për mbledhjen e të dhënave dhe hartimin e këtij raporti me gjetjet nga realizimi i planit strategjik 2018-2021.

2. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Mbështetur në dokumentet e mbledhura dhe nga të dhënat e ofruara gjatë nyervistave me akterë përgjegjës në zbatimin e planit strategjik, në vijim prezantohen të gjeturat kryesore nga analiza e këtyre të dhënave.

Objektivat kryesore janë të pasqyruara si në vijim:

1. Mësimdhënia, kërkimi dhe shërbimi
2. Burimet e mësimit dhe mbështetja e studentëve
3. Akreditimi dhe kontrollimi i cilësisë
4. Nivelet/Programet e kërkuara nga tregu
5. Zhvillimi i burimeve njerëzore
6. Zhvillimi i sistemit për informim publik
7. Llogaridhënia fiskale dhe përmirësimi i informacionit financiar të të dhënave
8. Globalizimi/Ndërkombëtarizimi

Disa nga vlerësimet e përgjithshme në zbatimin e kësaj strategjie janë:

- Një pjesë e madhe e aktiviteteve, në formulimin e tyre nuk kanë ndjekur rregullin SMART, si rrjedhim ka qenë e vështirë matja e realizimit të tyre
- Është e dukshme nevoja për të rishikuar planin strategjik dhe të marrë në konsideratë gjetjet e këtij raporti si dhe një qasje më gjithëpërfshirëse gjatë procesit të rishikimit
- Ka zhvillim pozitiv në disa prej objektivave të planit strategjik

3. METODOLOGJIA

Metodologjia e përdorur për hartimin e këtij raporti përfshin raportet nga monitorimi i implementimit të Planit Strategjik, të dhënat e mbledhura nga vlerësimi i aktiviteteve të cilat janë zhvilluar si dhe rishikimi i proceseve, të cilat kanë qenë një burim i rëndësishëm i informatave për hartimin e këtij dokumenti.

Gjatë hartimit të raportit vlerësues janë zhvilluar takime të ndryshme me njësitë akademike për implementimin e aktiviteteve përkatëse të objektivave strategjike me qëllim të diskutimit të vlerësimit të zbatimit të strategjisë.

Ky raport përmban vlerësimin e të gjitha aktiviteteve të parapara dhe të realizuara gjatë periudhës Janar – Shtator 2019. Raporti ofron një vlerësim real të arriturave që janë bërë në implementimin e strategjisë. Gjithashtu janë të pasqyruara edhe synimet dhe objektivat për të cilat nuk ka pasur progres.

Në fund, raporti përmban edhe rekomandimet të cilat janë ndërtuar mbi bazën e sfidave të identifikuar, me qëllim të identifikimit të aktiviteteve për të përmirësuar implementimin e strategjisë gjatë vitit të ardhshëm dhe arritjen e këtyre objektivave.

4. PROGRESI I ARRITUR SIPAS OBJEKTIVAVE

Objektivi Strategjik 1: Mësimdhënia, kërkimi & shërbimi

Objektivi specifik 1.1: Ndërveprimi me aktivitete mësimore.

Rrjedha e procesit mësimor, transferimi i njohurive, përvojës nga profesorët tek studentët mund të realizohet duke organizuar punëtori profesionale, si dhe prezantimet e projekteve profesionale të përbashkëta nga të dy palët si dhe nga punonjësit tjerë që mbështesin procesin mësimor në Universitet.

Afati Kohor:	2018 – 2021
Aktiviteti:	Organizimi i punëtorive profesionale me studentët profesorët si dhe nga punonjësit tjerë që mbështesin procesin mësimor në Universitet. Udhëheqësit e projekteve profesionale paraqesin projektet e tyre, secila NJA brenda Universitetit të paktën një punëtori gjatë vitit.
Statusi:	E pa realizuar
Arsyetimi:	Nuk ka dëshmi që është ndërmarrë ndonjë iniciativë për organizimin e aktiviteteve të tilla.

Afati Kohor:	2018 e në vazhdimësi
Aktiviteti:	Zhvillimi i bazës së të dhënave të projekteve profesionale, studimeve dhe ekspertizës. Arkivi të jetë vazhdimisht në dispozicion për punonjësit dhe studentët.
Statusi:	E realizuar pjesërisht
Arsyetimi:	Nga grupi profesional i angazhuar, është filluar zhvillimi i bazës së të dhënave të projekteve profesionale, projekteve në të cilat UMIB ka marrë pjesë si partner në aplikime në vitet e fundit

Objektivi specifik 1.2 Rritja e mundësive për zhvillim profesional të stafit akademik.

Përforcimi i universitetit në aspektin e numrit të SA të kualifikuar dhe që SA të jetë më kompetentë në mësimdhënie dhe për vlerësime në komisione profesionale për thirrje akademike

Afati Kohor:	2018 – process i vazhdueshëm
Aktiviteti:	Harmonizimi dhe rritja e numrit të profesorëve në raport me numrin e studentëve, sipas buxhetit të UMIB-it. Rritja e koeficientit të numrit të profesorëve / numrit të studentëve, sipas mundësive që i lejon buxheti i UMIB.
Statusi:	E realizuar
Arsyetimi:	

Gjatë vitit 2019 kanë krijuar marrëdhënie të rregullt pune në UMIB, gjithsej 3 staf akademik

Afati Kohor: 2018 – process i vazhdueshëm

Aktiviteti:: Vlerësimi i performancës së profesorëve përmes një ankete të studentëve.

Statusi: E realizuar

Arsyetimi: Gjatë vitit 2019 është realizuar anketa me studentët për vlerësimin e performancës së stafit akademik. Raporti i publikuar në ueb faqe të UMIB.

Afati Kohor: 2018 – process i vazhdueshëm

Aktiviteti:: Rritja e pjesëmarrjes së mjeteve elektronike në mësimdhënie.

Statusi: Jo i matur

Arsyetimi: Mungojnë të dhënat për matjen e realizimit të këtij aktiviteti

Objektivi specifike 1.3. Të përmirësohen udhëzimet duke paraqitur metodologji të reja (p.sh. mësimi elektronik, të Mësuarit e aplikuar etj.) të sigurohet zhvillimi i trupit pedagogjik në pedagogji

Përmirësim të njohurive të studentëve & zotërimi, rritja e të menduarit kritik, kalimi në metoda të reja të mësimdhënies larg formatit të ligjëratave të thjeshta, evoluim në një sistem testimi formativ (P.sh. të bazuar në kompetencë, aktiv/të aplikuar etj.)

Afati Kohor: 2018 – process i vazhdueshëm

Aktiviteti:: Intensifikimi i punës së profesorit në botimin e teksteve shkollore dhe materialeve të tjera mësimore

Statusi: E realizuar

Arsyetimi: Gjatë vitit 2019 është përfunduar procesi për publikimin e 5 botimeve [tekste] me autorë stafin akademik të UMIB

Afati Kohor: 2018 – process i vazhdueshëm

Aktiviteti:: Të trajnohet i gjithë trupi pedagogjik në teknikat e reja të mësimdhënies dhe softuerit

Statusi: E pa realizuar

Arsyetimi: Gjatë vitit 2019 nuk ka dëshmi që janë organizuar aktivitete të tilla.

Afati Kohor: 2018 – process i vazhdueshëm

Aktiviteti:: Trajnimi i mësimdhënësve të UMIB-it-së në kuadër të zhvillimit profesional.

Statusi:	E pa realizuar
Arsyetimi:	Gjatë vitit 2019 nuk ka dëshmi që janë organizuar aktivitete të tilla

Objektivi specifike 1.4. Zbatimi i nismave të reformës në UMIB.

Kjo çështje është ngritur nga vetmotivimi dhe entuziazmi i stafit akademik që synojnë të zbatojn një numër masash me qëllim mbështetjes për rritjen cilësisë së mësim

Afati Kohor:	2018 – process i vazhdueshëm
Aktiviteti::	UMIB-i bënë përpjekjet e saj për të zbatuar proceset e reformave evropiane dhe për ta bërë këtë përmirësim në harmonizim me strukturën e arsimit të lartë dhe kuadrin ligjor arsimor në përputhje me nevojat specifike të vendit, me qëllim të përmirësimit të efektivitetit dhe konsistencës së masave shoqëruese përmes një korniza për të forcuar kapacitetet institucionale, bashkëpunimin dhe zhvillimin.
Statusi:	Jo i matur
Arsyetimi:	Formulimi i aktivitetit shumë i përgjithshëm, mungesa e treguesve specifikë për këtë aktivitet e bëjnë të pamundur matjen e realizimit të tij.

Afati Kohor:	2018 – process i vazhdueshëm
Aktiviteti:	UMIB-i në periudhën e ardhshme duhet të bëjë çdo gjë të nevojshme për të optimizuar proceset përmes kornizave ekzistuese ose të reja ligjore si dhe në bashkëpunimi të ngushtë me të gjithë faktorët relevant pjesëmarrës në këto procese, në mënyrë që këto institucione të arsimit të lartë të jenë konkurruese në tregun evropian të arsimit të lartë.
Statusi:	Jo i matur
Arsyetimi:	Formulimi i aktivitetit shumë i përgjithshëm, mungesa e treguesve specifikë për këtë aktivitet e bëjnë të pamundur matjen e realizimit të tij.

Objektivi specifike 1.5. Burimet e Mësimi dhe mbështetja e studentëve.

Universiteti do të sigurojë burime të mjaftueshme adekuate dhe bashkëkohore për mësim, të cilat do të jenë në dispozicion të studentëve në të gjitha programet e studimit. Përmirësimin e komunikimit të studentëve-profesor.

Afati Kohor:	2018 – process i vazhdueshëm
Aktiviteti::	Rritja e fondit të bibliotekës me libra dhe revista profesionale
Statusi:	Jo e realizuar
Arsyetimi:	Gjatë vitit 2019 nuk janë blerë fond i ri i librave dhe revistave për bibliotekën

Afati Kohor:	2018 – process i vazhdueshëm
---------------------	------------------------------

Aktiviteti::	Rritja e pjesës të punës praktike dhe përmirësimi i pajimit të laboratoreve me pajisjeve laboratorike
Statusi:	E realizuar pjesërisht
Arsyetimi:	Gjatë vitit 2019 ka pasur investime në pajisje laboratorike duke krijuar kushte më të mira për punë në laboratore.....

Objektivi specifike 1.6. Krijimi i kritereve të përsosmërisë dhe relevancës.

Duke promovuar përsosmërinë dhe rëndësinë shkencore, qëllimi është, përveç botimit të një numri më të madh të hulumtimeve, të arrihet një nivel që do të mundësojë krijimin e njohurive të reja, zhvillimin teknologjive ekzistuese dhe përcaktimin e specializimeve shkencore të UMIB-it. Përsosja shkencore dhe rëndësia do të vlerësohet sipas standardizimit ndërkombëtar.

Afati Kohor:	2018 – process i vazhdueshëm
Aktiviteti::	Krijimi i një modeli të ri të financimit të aktiviteteve të bazuara në ekselencën e tyre
Statusi:	E pa realizuar
Arsyetimi:	Nuk ka të dhëna për realizimin e këtij aktiviteti

Afati Kohor:	2018 – process i vazhdueshëm
Aktiviteti::	Përzgjedhja e projekteve, përveç rishikimeve kompetente (duke përfshirë ndërkombëtare rishikimet), një sërë treguesish të performancës do të përdoren për t'u përdorur për vlerësim projekti.
Statusi:	E pa realizuar
Arsyetimi:	Nuk ka të dhëna për realizimin e këtij aktiviteti.
Afati Kohor:	2018 – process i vazhdueshëm
Aktiviteti::	Modeli i financimit bazuar në financimin e projektit dhe institucional përmes: Vlerësimi i shkallës dhe cilësisë së hulumtimit në aspektin e ekselencës; Bashkëpunimi shkencor dhe ndërdisiplinor; Bashkëpunimi me ekonominë dhe kulturën, dhe rëndësia sociale e hulumtimit
Statusi:	E pa realizuar
Arsyetimi:	Formulimi i aktivitetit shumë i përgjithshëm, mungesa e treguesve specifikë për këtë aktivitet e bëjnë të pamundur matjen e realizimit të tij.

Objektivi specifike 1.7. Mbështetje për hulumtuesit e rinj.

Programet që do të zhvillohen ekskluzivisht për hulumtuesit e rinj do të jenë në përputhje me praktikën dhe standardet evropiane për mbështetje të shkencëtarëve të rinj, të krijuar në bazën e barabartë të kornizës për arsimin e lartë në sektorin publik dhe privat.

Afati Kohor:	2018 – 2021
Aktiviteti:	Mbështetja dhe promovimi i shkencëtarëve të rinj është vlerë shtesë për zhvillimin e proceseve akademike-shkencore në institucionet e arsimit të lartë. Të formohen kritere në bazë të të cilave do të mbështetet puna e hulumtuesve të rinj dhe në këtë mënyrë do të mundësohet krijimi i një rrjeti cilësor i hulumtuesve të rinj nga të gjitha fushat shkencore dhe duhet të inicohet iniciativa për të krijuar një hapësirë që do ta mundësojë studiuesve të rinj për të publikuar punën e tyre në platformat elektronike EEB.
Statusi:	E realizuar pjesërisht
Arsyetimi:	Janë organizuar disa aktivitete në mbështetje dhe promovim të studentëve, asistentëve dhe profesorëve të rinj, që tregojnë për një rritje në vazhdimësi të mbështetjes së hulumtuesve të rinj.

Objektivi Strategjik 2: Zhvillimi i shërbimit ndaj studentëve

Objektivi specifik 2.1: Ngritja e arritjeve të studentëve gjatë studimeve.

Ngritja e arritjeve të studentëve në të gjitha programet e studimit në drejtim të suksesit të rezultateve të studimit dhe të të nxënit.

Afati Kohor:	2018 i vazhdueshëm
Aktiviteti:	Vlerësimi meritor i studentëve në bazë të kritereve dhe rregullave publike, adekuate dhe të qarta dhe me të cilat ata janë të njohur paraprakisht në të gjitha programet e studimit.
Statusi:	E realizuar
Arsyetimi:	Janë ofruar bursat e studimit si dhe bursat për studentët e shkëlqyeshëm

Afati Kohor:	2018 i vazhdueshëm
Aktiviteti:	Përputhshmëria e regjistrimit në një vit më të lartë të studimit të mbahen në intervalin deri në 50% nga viti paraprak
Statusi:	E realizuar
Arsyetimi:	Të dhënat nga statistikat për studentë tregojnë realizimin e aktivitetit

Afati Kohor:	2018 i vazhdueshëm
Aktiviteti:	Rritja e suksesit të kalueshmërisë të studentëve nga studimet e ciklit të parë në studimet e ciklit të dytë deri në 25%;
Statusi:	E realizuar pjesërisht
Arsyetimi:	

Të dhënat nga statistikat për studentë tregojnë realizimin e pjesshëm të aktivitetit

Afati Kohor: 2018 i vazhdueshëm

Aktiviteti: Shpërblimi i studentëve të dalluar gjatë vitit akademik.

Statusi: E realizuar

Arsyetimi: Të dhënat nga statistikat për studentë tregojnë realizimin e plotë të aktivitetit – kanë marrë bursa 72 studentë

Afati Kohor: 2018 i vazhdueshëm

Aktiviteti: Shkurtimi i kohëzgjatjes mesatare të studimit krahasuar me periudhën e mëparshme për çdo program studimi;

Statusi: E realizuar pjesërisht

Arsyetimi: Të dhënat nga statistikat për studentë tregojnë realizimin e pjesshëm të aktivitetit

Afati Kohor: 2018 i vazhdueshëm

Aktiviteti: Përqindje më të ulët të studentëve të ç’regjistruar dhe rritja e numrit të studentëve që kanë vazhduar studimet pasi që kanë humbur vitin paraprak

Statusi: E realizuar

Arsyetimi: Të dhënat nga statistikat për studentë tregojnë realizimin e aktivitetit. Në krahasim me vitin e kaluar përqindja e studentëve braktisës është zvogëluar 6 herë.

Afati Kohor: 2018 i vazhdueshëm

Aktiviteti: Rritja e notës mesatare dhe numrit të studentëve të diplomuar

Statusi: E realizuar pjesërisht

Arsyetimi: Numri i studentëve të diplomuar është rritur minimalisht

Objektivi specifik 2.2: Satisfaksioni i studentëve.

Ngritja e satisfaksionit të përgjithshëm të studentëve

Afati Kohor: 2018 i vazhdueshëm

Aktiviteti:	Rritja e ofertës së aktiviteteve jashtë mësimore (rekreacion, forma informale të arsimit, kurse), të organizuara nga Universiteti, shoqatat studentore,
Statusi:	E realizuar
Arsyetimi:	Janë zhvilluar aktivitetet e parapara.

Afati Kohor:	2018 i vazhdueshëm
Aktiviteti:	ligjërata për t'u mundësuar studentëve të përjetojnë përvojat botërore të situatave të jetës reale ("studim i rastit"),
Statusi:	E realizuar pjesërisht
Arsyetimi:	Janë zhvilluar disa ligjërata me profesorë eminentë vendorë dhe ndërkombëtarë.

Afati Kohor:	2018 i vazhdueshëm
Aktiviteti:	Ankesat dhe kërkesat e studentëve të trajtohen në mënyrë korrekte dhe me afat të shkurtër.
Statusi:	E realizuar
Arsyetimi:	Ankesat dhe kërkesat e studentëve janë trajtuar në mënyrë korrekte dhe me afat të shkurtër.

Objektivi specifik 2.3: Alumni.

Analiza e feedback-ut (treguesëve) të tregut rreth punësimit të studentëve të diplomuar.

Afati Kohor:	2018 i vazhdueshëm
Aktiviteti:	Analiza e feedback-ut (treguesëve) të tregut rreth punësimit të studentëve të diplomuar. Komunikimi me ish studentët dhe forcimi i shoqatave të të diplomuarve (alumni) me qëllim të promovimit të reputacionit të Universitetit brenda dhe jashtë vendit; Azhurimi vjetor i bazës së të dhënave të studentëve të diplomuar dhe mundësisht vëmendje të kushtohet krijimi i një baze të dhënash për hukumtuesit e rinj që janë jashtë vendit.
Statusi:	E realizuar
Arsyetimi:	Janë realizuar disa analiza dhe vlerësime; baza e të dhënave për studentë është plotësuar.

Objektivi Strategjik 3: Akreditimi dhe kontrolli i cilësisë

Objektivi specifik 3.1: Ngritja e arritjeve të studentëve gjatë studimeve.

Inkurajimi i vazhdueshëm i përmirësimit të programeve të studimit (në përputhje me Deklaratën e Bolonjës dhe Zonën Europiane të Arsimit të Lartë).

Afati Kohor:	2018 dhe proces i vazhdueshëm
Aktiviteti:	Kontakti me institucionet ndërkombëtare; Zhvillimi i bazës ligjore për bashkëpunim; Zhvillimi dhe akreditimi i programit për studime ndërdisiplinore.
Statusi:	E realizuar pjesërisht
Arsyetimi:	Janë krijuar disa kontakte me institucione ndërkombëtare, me disa projekte ku partner është UMIB. Kanë filluar punët në drejtim të rregullimit të infrastrukturës ligjore, por nuk është zhvilluar asnjë program ndërdisiplinar.

Objektivi specifik 3.2: Zhvillimi i sistemit të sigurimit të cilësisë.

Krijimi organizativ i sistemit të sigurimit të cilësisë. Për të mbështetur arritjen e qëllimeve të vendosura, duhet të krijohet një strukturë e përshtatshme organizative e cila do të integrohet në sistemin e sigurimit të cilësisë të arsimit të lartë në Universitet.

Afati Kohor:	2018 dhe proces i vazhdueshëm
Aktiviteti:	Emërimi i Komisionit të Cilësisë dhe hartimi i rregullorës për përcaktimin e detyrave dhe përgjegjësi të Komisionit të Cilësisë.
Statusi:	E pa realizuar
Arsyetimi:	Nuk është bërë as krijimi i Komisionit dhe as hartimi i rregullores.

Objektivi specifik 3.3: Zhvillimi i mekanizmit për sigurim të cilësisë.

Me qëllim të monitorimit të vazhdueshëm dhe përmirësimit të sistemeve të sigurimit të cilësisë në UMIB, duhet të zhvillohen mekanizmat përgjegjëse lidhur me këtë çështje.

Afati Kohor:	2018 dhe proces i vazhdueshëm
Aktiviteti:	Përcaktimi i mekanizmave për sigurimin e cilësisë nënkupton mekanizma të brendshëm për sigurimin e cilësisë së mësimdhënies, punës shkencore dhe profesionale.
Statusi:	E realizuar pjesërisht
Arsyetimi:	Janë hartuar dhe zhvilluar vetëm pyetësorët me studentët për të vlerësuar mësimdhënësit dhe me stafin administrativ për shërbimet administrative.

Afati Kohor:	2018 dhe proces i vazhdueshëm
---------------------	-------------------------------

Aktiviteti:	Vetëvlerësimi nënkupton krijimin e një procedure për vlerësimin e Universitetit në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë të Republikës gjatë vitit akademik.
Statusi:	E realizuar pjesërisht
Arsyetimi:	Janë hartuar dhe zhvilluar pyetësorët me studentët për të vlerësuar mësimdhënësit, dhe me stafin administrativ dhe me ALUMNI, por jo edhe me akterët tjerë.

Afati Kohor:	2018 dhe proces i vazhdueshëm
Aktiviteti:	Krijimi i analizës SËOT të secilit fakultet veç e veç, e mandej bazuar në raporte parciale, të përpilohet analiza e plotë SËOT e tërë Universitetit.
Statusi:	E realizuar
Arsyetimi:	Është hartuar analiza SËOT e cila është dorëzuar me raportin e vetëvlerësimit për institucionin.

Afati Kohor:	2018 dhe proces i vazhdueshëm
Aktiviteti:	Vlerësimi i punës së shërbimeve profesionale.
Statusi:	E realizuar
Arsyetimi:	Është hartuar dhe zhvilluar pyetësori nga administrata, si dhe është bërë publik në ëeb raporti me gjetjet.

Objektivi specifik 3.4: Zhvillimi i Procedures së verifikimit të cilësisë së sistemit të Arsimit të lartë.

Me qëllim të sigurimit të efektivitetit të implementimit të sistemit të sigurimit të cilësisë, duhet të zhvillohen, dokumentohen dhe zbatohen procedurat periodike të kontrollit të brendshëm dhe të jashtëm.

Afati Kohor:	2018 dhe proces i vazhdueshëm
Aktiviteti:	Përcaktimi i procedurës për kontrollin e brendshëm -auditimi i sistemit të sigurimit të cilësisë
Statusi:	E pa realizuar
Arsyetimi:	Përvec Rregullores për cilësi dhe vlerësim të miratuar më 2018, nuk është nxjerrë asnjë dokument tjetër që qartëson procedurat.

Afati Kohor:	2018 dhe proces i vazhdueshëm
---------------------	-------------------------------

Aktiviteti:	Përcaktimi i procedurave të auditimit të brendshëm të një sistemi të sigurimit të cilësisë që lejon verifikimin e brendshëm të efektivitetit të procedurave të tij në të gjitha nivelet dhe fushat e veprimit. Rezultati i auditimit të brendshëm është raport që shërben si bazë për procesin e verifikimit të jashtëm të pavarur të sistemit të sigurimit të cilësisë.
Statusi:	E realizuar pjesërisht
Arsyetimi:	Përvec Rregullores për cilësi dhe vlerësim të miratuar më 2018, nuk është nxjerrë asnjë dokument tjetër që qartëson procedurat. Është hartuar një raport me gjetje dhe rekomandime pas pyetësorëve të zhvilluar më stafin akademik, stafin administrativ dhe ALUMNI.

Objektivi specifik 3.5: Vetëvlerësimi i cilësisë.

Vetëvlerësimi i cilësisë të realizohet (vëzhgohet) vazhdimisht gjatë gjithë vitit shkollor.

Afati Kohor:	2018 dhe proces i vazhdueshëm
Aktiviteti:	Anketimi (Sondazhet) i studentëve (vlerësimi i studentëve për mësimdhënie, metodave të mësimdhënies, metodat e vlerësimi në provim, programit të studimit dhe organizimi i studimeve, ekzaminimi i punës së shërbimeve administrative dhe profesionale ...)
Statusi:	E realizuar
Arsyetimi:	Në përfundim të vitit akademik janë realizuar pyetësorët nga ana e Zyrës për cilësi dhe janë nxjerrë raportet.

Afati Kohor:	2018 dhe proces i vazhdueshëm
Aktiviteti:	Anketimi i të punësuarve.
Statusi:	E realizuar pjesërisht
Arsyetimi:	Në nivel të umib nuk janë zhvilluar këta pyetësor, por disa njësi akademike kanë zhvilluar pyetësor me punëdhënësinë për të aplikuar në programe të reja.

Afati Kohor:	2018 dhe proces i vazhdueshëm
Aktiviteti:	Anketimi i studentëve të diplomuar
Statusi:	E realizuar
Arsyetimi:	Është realizuar pyetësor me të diplomuarit e UMIB dhe raporti me gjetje dhe rekomandime është bërë publik në ëeb të UMIB.

Afati Kohor:	2018 dhe proces i vazhdueshëm
---------------------	-------------------------------

Aktiviteti:	Zbatimi i procedurave të tjera të parashikuara me planin e vetëvlerësimit.
Statusi:	E pa matshme
Arsyetimi:	Nuk është qartësuar se cilat janë procedurat tjera, nuk ka një plan veprimi, dhe nuk janë zhvilluar meknazima shtesë.

Objektivi specifik 3.6: Përfshirja e studentëve në sigurimin e cilësisë.

Përfaqësimi i studentëve në të gjitha proceset për sigurim të cilësisë në UMIB nëpërmjet rishikimit të programeve të studimit, departamentit, fakultetit, shërbimeve për studentë dhe në nivel Institucional të universitetit.

Afati Kohor:	2018 dhe proces i vazhdueshëm
Aktiviteti:	Hartimi i procedurave për përfaqësim të studentëve në Sigurim të cilësisë.
Statusi:	E pa realizuar
Arsyetimi:	Përveq Rregullores për cilësi dhe vlerësim e hartuar më 2018, nuk është nxjerrë asnjë dokument tjetër që rregullon përfaqësimin e tyre.

Objektivi specifik 3.7: Akreditimi i programeve.

Studimet themelore, dhe pasuniversitare sigurojnë përvetësimin e arsimit të lartë bazuar në punën kërkimore shkencore.

Afati Kohor:	2018 - 2021
Aktiviteti:	Punimi i punës së Bachelor Masterit dhe Doktoratës të jetë një kontribut i drejtpërdrejtë shkencor dhe paraqet bazën për të dëshmuar kompetencat e tyre shkencore lidhur me punimin. Shpërndarja e njohurive dhe interpretimi i arritjeve shkencore është po aq e rëndësishme sa edhe krijimi i saj, kështu që qëllimi i Universitetit, nëpërmjet reformës së studimit të doktoraturës, si cikli i tretë i arsimit të lartë, është grumbullimi i njerëzve që krijojnë dhe shpërndajnë njohuri.
Statusi:	E realizuar pjesërisht
Arsyetimi:	UMIB ka arritur të akreditoj në vitin 2019 programe në nivelin bachelor dhe mastër, por, UMIB nuk ka zhvilluar dhe as aplikuar për studime të doktoraturës.

Afati Kohor:	2018 - 2021
Aktiviteti:	Rritja e suksesit të studimit, me qëllim të përfundimit të studimit brenda afateve të caktuara (zbatimin e masave për të inkurajuar progresin e

	vazhdueshëm sipas viteve përmes anketave, vlerësimin sipas kredive ECTS të arritura, në përputhje me programet e studimit). Rritja e numrit të doktoratave dhe masterave të mbrojtura në Universitet, Inkurajimi dhe motivimi i studentëve të bachelor-it të diplomuar me infomimin në kohë për të vazhduar studimet; Angazhimi i një numri të madh të profesorëve në mentorimin e studentëve për aritjet e e thirrjeve të stafit akademik dhe studentëve përmes punës profesionale të arritjeve shkencore-mësimore;
Statusi:	E realizuar pjesërisht
Arsyetimi:	Studentët kanë shfaqur sukses në diplomim dhe punësim pas diplomimit, nga niveli bachelor dhe ai master. Por, nuk është zhvilluar asnjë hulumtim e as ndonjë program në studime të ciklit të tretë – doktoraturës. ECTS-të janë sistem të cilin umib e përdorë në të gjitha programet e tij.

Afati Kohor:	2018 - 2021
Aktiviteti:	Inkurajimi i botimit të punimeve të përbashkëta shkencore - studentë dhe mentorë (duke botuar të paktën 2 punime të përbashkëta çdo vit).
Statusi:	E realizuar pjesërisht
Arsyetimi:	Ka raste kur studentët kanë botuar së bashku me profesorët e tyre, por jo prej një mesatareje prej 2 punimesh në vit.

Objektivi specifik 3.8: Puna kërkimore – shkencore.

Puna kërkimore-shkencore bazohet në hulumtime themelore, aplikative dhe zhvillimore që grumbullon materiale shkencore, sistemon njohuritë ekzistuese shkencore, formon dhe paraqet aritjet shkencore. Ai punon në projekte shkencore vendore dhe ndërkombëtare, boton vepra në revista dhe punimet e mbledhjeve shkencore, si dhe aktivitete që lidhen me popullarizimin e shkencës nëpërmjet tribunave, tryezave të rrumbullakëta, konferencave, simpoziumeve etj.

Afati Kohor:	2018 e në vazhdimësi
Aktiviteti:	Rritja e numrit të publikimeve të botuara në revistat të indeksuara në bazat e bibliotekave relevante, në përputhje me rregullat mbi kushtet për përzgjedhje në titujt shkencorë.
Statusi:	E realizuar pjesërisht
Arsyetimi:	Në vitin 2019 ka rritje të numrit të përgjithshëm të publikimeve, por nuk ka qenë e mundur të verifikohen nëse janë në përputhje me kriteret e paraqitura.

Afati Kohor:	2018 – process i vazhdueshëm
---------------------	------------------------------

Aktiviteti:	Rritja e numrit të pjesëmarrjeve në projekte shkencore vendore (të përcaktohet një rritje e realizueshme deri në fund të kësaj Strategjie, pra një plan trevjeçar).
Statusi:	E realizuar pjesërisht
Arsyetimi:	Vazhdonë përfshirja e profesorëve dhe studentëve në projekte shkencore vendore, por nuk mund të matet niveli i realizimit pa indikator matës.

Afati Kohor:	2018 – process i vazhdueshëm
Aktiviteti::	Rritja e numrit të pjesëmarrjeve në projekte shkencore ndërkombëtare (të përcaktohet një rritje e realizueshme deri në fund të kësaj Strategjie, pra një plan trevjeçar);
Statusi:	E realizuar pjesërisht
Arsyetimi:	Vazhdonë përfshirja e profesorëve dhe studentëve në projekte shkencore ndërkombëtare, por nuk mund të matet niveli i realizimit pa indikator matës.

Afati Kohor:	2018 – process i vazhdueshëm
Aktiviteti:	Forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar nëpërmjet krijimit të bashkëpunimit me institute të huaja kërkimore shkencore;
Statusi:	E realizuar
Arsyetimi:	Gjatë vitit 2019 janë arritur marrëveshje të reja bashkëpunimi me insitute ndërkombëtare shkencore

Afati Kohor:	2018 – process i vazhdueshëm
Aktiviteti::	Rritja e financimit të aktiviteteve shkencore për SA në thirrje shkencore; E realizuar pjesërisht
Statusi:	UMIB ka organizuar aktivitete shkencore, siq janë Konferencat Shkencore, por nuk do të thot kjo që ka qenë e lidhur me thirrje shkencore të SA
Arsyetimi:	

Afati Kohor:	2018 – process i vazhdueshëm
Aktiviteti::	Mbajtja e forumeve shkencore në universitet, organizimin dhe pjesëmarrja në aktivitetete për popullarizimin e shkencës; vendosjen e materialeve të duhura në faqen e internetit të Universitetit. E realizuar
Statusi:	Janë realizuar aktivitete ndryshme shkencore në kuadër të njësisive akademike (Konferenca, ligjerata, trajnime) si dhe është pasuruar faqja e internetit të UMIB me informacione rreth aktiviteteve mësimore dhe shkencore.
Arsyetimi:	

Afati Kohor:	2018 – process i vazhdueshëm
Aktiviteti::	Përfshirja e studentëve më të mirë në punën për projektet shkencore
Statusi:	E realizuar pjesërisht
Arsyetimi:	Gjatë vitit 2019 vazhdon përfshirja e studentëve në projekte shkencore, por aktiviteti në vete nuk mund të jetë saktë i matshëm

Afati Kohor:	2018 – process i vazhdueshëm
Aktiviteti::	Sigurimi i pajisjeve kompjuterike të nevojshme si mjet themelor në punën shkencore dhe kërkimore; E realizuar
Statusi:	Edhe në vitin 2019 është vazhduar me sigurimin e kompjuterëve për
Arsyetimi:	nevojat e stafit akademik.

Afati Kohor:	2018 – process i vazhdueshëm
Aktiviteti::	Monitorimi dhe përmirësimi i programeve ekzistuese dhe blerja e programeve dhe aplikacioneve të reja të licencuara për kompjuter.
Statusi:	E realizuar
Arsyetimi:	Edhe në vitin 2019 është vazhduar me sigurimin e softuerëve të licensuar për fusha të ndryshme.

Objektiva specifike 3.9. Përparimi shkencor dhe përsosmëria.

Zbatimi i suksesshëm dhe përmbushja e detyrave dhe qëllimeve të punës kërkimore shkencore varet kryesisht nga ajo se sa është kompetent një mësues në fushën shkencore dhe kërkuese (hulumtuese). Ngritja e tyre e vazhdueshëm është një parakusht për përmbushjen e detyrave të qëllimit të mëparshëm strategjik. Përcaktimi dhe monitorimi sistematik i treguesve të efektit mund të pasqyrojnë një pamje realiste dhe mundësi për avancimin e individit dhe të gjithë Universitetit.

Afati Kohor:	2018 – process i vazhdueshëm
Aktiviteti::	Përforsimi i kompetencave shkencore të profesorëve në tituj kërkimor-shkencorë.
Statusi:	Jo e matur
Arsyetimi:	Nuk ka të dhëna që mbasin këtë aktivitet

Afati Kohor:	2018 – process i vazhdueshëm
Aktiviteti::	Inkurajimi i përparimit të profesorëve të rinj
Statusi:	E realizuar pjesërisht

Arsyetimi: Profesorët e rinj janë të angazhuar në projekte hulumtuese, por nuk ka të zhvilluar një politikë për inkurajuar ata në mënyrë të vecantë

Afati Kohor: 2018 – process i vazhdueshëm

Aktiviteti: Inkurajimi i mobilitetit dhe përmirësimit të punës së profesorëve

Statusi: E realizuar

Arsyetimi: Janë nënshkruar memorandume bashkëpunimi për mobilitet, si dhe mbajtur sesione informuese për mundësit e mobilitetit dhe bashkëpunimit në projekte ndërkombëtare.

Afati Kohor: 2018 – process i vazhdueshëm

Aktiviteti: Rritja e numrit të rishikimeve (recensioneve) të punimeve shkencore, projekteve dhe programeve.

Statusi: Jo e matur

Arsyetimi: Nuk ka të dhëna për matjen e aktivitetit

Afati Kohor: 2018 – process i vazhdueshëm

Aktiviteti: Inkurajimi i angazhimit të profesorëve në punën e komiteteve dhe shoqatave shkencore dhe bashkëpunimi me subjektet afariste përmes ofrimit dhe realizimit të projekteve reciprokisht interesante.

Statusi: E realizuar pjesërisht

Arsyetimi: Vazhdon angazhimi i profesorëve në projekte, përfshirë edhe sektorin privat, por nuk mund të matet niveli i realizimit pa indikator matës

Objektiva specifike 3.10. Zhvillimi dhe menaxhimi i burimeve (resurseve) resurset materiale. Përmirësimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e burimeve materiale të Universitetit në mënyrë që të ofrojë një mjedis pune cilësor dhe të sigurojë mjete moderne për mirëmbajtjen e procesit mësimor, kërkimit shkencor dhe punës profesionale.

Afati Kohor: 2018 – process i vazhdueshëm

Aktiviteti:

- Përmirësimi i pajisjeve me pajisje të TI (kompjuterat, laptopë, projektorë, etj.), të punonjësve dhe studentëve,
- Përmirësimi dhe modernizimi i pajisjeve të laboratoreve,
- Blerja e softëareve të rinj /licencave dhe modernizimin e atyre ekzistuese,
- Rritja e fondit të bibliotekës me libra dhe revista profesionale,
- Në procesin e planifikimit të prokurimit të burimeve materiale për çdo vit të përfshihen të gjitha pjesët organizative të Universitetit.

Statusi: E realizuar

Arsyetimi: Secila nga aktivitetet e sipër përmenduar kanë pasur vazhdimësi më 2019.

Objektivi Strategjik 4: Nivele/ Programe të kërkuara nga tregu

Objektivi specifik 4.1: Të implementohet programet e diplomës në përputhje me nevojat e tregut. Të bëhen analiza të tregut për të identifikuar se cilat programe janë relevante me nevojat e tregut

Identifikimi i programeve më të mira për zhvillim në pajtim me nevojat e tregut; Të sigurohet udhëzim dhe strukturë se çfarë diplomash nevojiten për të plotësuar nevojat e punësimit në Kosovë. Rishikimet periodike të programeve ekzistuese të studimit duke u bazuar në indikatorët të kërkesave të tregut të punës.

Afati Kohor: 2018 i vazhdueshëm

Aktiviteti: -Miratimi i programeve; -Zbatimi i marrëveshjeve; -Zhvillimi i kurrikulës; -Implementimi i zhvillimit të fakultetit.

Statusi: E realizuar pjesërisht

Arsyetimi: Është iniciuar procesi i draftimit të rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës. Rregullorja e re do të miratohet në fillim vitin 2020.

Afati Kohor: 2018 i vazhdueshëm

Aktiviteti: Të krijohen komitete këshilluese për industri specifike brenda kornizës së njësisë akademike të UMIB-it;

Statusi: E realizuar pjesërisht

Arsyetimi: Është iniciuar formimi i komiteteve këshilluese për industry. Deri tani janë 2 njësi akademike që kanë komitetet këshilluese

Afati Kohor: 2018 i vazhdueshëm

Aktiviteti: Bashkëpunimi me Odën Ekonomike të Kosovës.

Statusi: E pa realizuar

Arsyetimi: Janë realizuar disa vizita nga përfaqësuesit e OEK kryesisht me karakter informativ rreth punës dhe aktivitetëve të OEK

Afati Kohor: 2018 i vazhdueshëm

Aktiviteti: Të institucionalizohen programet e praktikës si pjesë të kurrikulave..

Statusi:	E realizuar pjesërisht
Arsyetimi:	Është bërë rishikimi i disa programeve dhe praktika ka zënë një përqindje më të lartë.

Objektivi specifik 4.2: Rritja e bashkëpunimit me sektorin publik dhe privat

Zhvillimi i marrëdhënieve interaktive për botën e tregut të punës dhe të ndërmarrjeve.

Afati Kohor:	2018 i vazhdueshëm
Aktiviteti:	Baza ligjore të përshtatshme që përcaktojnë qartë të gjithë mekanizmat dhe instrumentet për sigurimin e programeve profesionale në pajtim me kërkesat e tregu.
Statusi:	E pa realizuar
Arsyetimi:	Nuk ofrojmë programe profesionale

Afati Kohor:	2018 -2021
Aktiviteti:	Të forcohet trekëndëshi i njohurive inovative në mes të edukimit, kërkimit dhe biznesit.
Statusi:	E realizuar
Arsyetimi:	Është zhvilluar panairi i karrie UMIB dhe FE ka organizuar dy tryeza të rrumbullakëta me qëllim të forcimit të bashkëpunimit ndërmjet universiteteve dhe biznesit. UMIB ka formuar bordin industrial këshill dhënës me qëllim identifikimin e programeve më të mira për zhvillim në pajtim me nevojat e tregut të punës dhe bashkarisht me MNI ka themeluar Qendrën e inovacionit ku janë mbajtur disa trajnime për startup.rës

Afati Kohor:	2018 -2021
Aktiviteti:	Diskutime për zhvillim të karrierës dhe informimi i studentëve lidhur me organizimet e panairëve të karrierës ,
Statusi:	E realizuar
Arsyetimi:	Është zhvilluar panairi i karrierës.

Afati Kohor:	2018 -2021
Aktiviteti:	Të organizohet një tryezë e rrumbullakët për fuqizimin e mundësisë së punësimit gjatë së cilës të punësuarit dhe palët e interesuara relevante reflektojnë me zhvillim të strategjis kooperative për të përmirësuar tranzicionin e studentëve.

Statusi:	E realizuar
Arsyetimi:	Janë zhvilluar dy tryeza të rumbullakëta për këtë qëllim.

Objektivi Strategjik 5: Burimet njerëzore

Objektivi specifik 5.1: Përpilimi i organogramit të ri të stafit

Përgatitja e tabelës të strukturës organizative (aktuale dhe të ardhshme, organograme në çdo fakultet). Definimi i detyrave të divizioneve dhe përditësimi i rregulloreve për stafin duke u bazuar në nevoja.

Afati Kohor:	2018– 2021
Aktiviteti:	Draft rregullorja e re
Statusi:	E pa realizuar
Arsyetimi:	Është iniciuar procesi i draftimit të rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës. Rregullorja e re do të miratohet në fillim vitin 2020.

Objektivi specifik 5.2: Ngritja e kapaciteteve dhe trajnimi i vazhdueshëm i stafit akademik dhe stafit administrativ

Ky objektivi ka për qëllim: definimin e fushave ku nevojitet trajnimi; kontaktimi i donatorëve ndërkombëtarë; dërgimi i stafit në kurse të shkathësive gjuhësore dhe kompjuterike.

Afati Kohor:	2018 – process i vazhdueshëm
Aktiviteti:	Organizimi i punëtorive trajnuese; -Draftimi i programit për trajnim; -Kurset obligative për stafin.
Statusi:	Pjesërisht i realizuar
Arsyetimi:	<ul style="list-style-type: none"> - Në fund të vitit 2019 dhe në fillim të vitit 2020 do të organizohen punëtori trajnuese: Trajnimi bazik dhe trajnimi i avancuar për mësimdhënësit; trajnimi për hartimin e syllabusit; trajnimi për ECTS kreditë për mësimdhënësit dhe administratën. - Në fillim të vitit kalendarik 2019 është hartuar dhe miratuar plani i trajnimit për stafin administrativ. Në bazë të këtij plani gjatë vitit 2019 në trajnimet profesionale të organizuara nga IKAP (Instituti i Kosovës për Administratë Publike) janë trajnuar 2 staf administrativ. Zyrtarët financiar në baza të rregullta vjetore trajnohen dhe licencohen nga Ministria e Financave. - Gjatë viti 2019 janë trajnuar 2 staf akademik në kuadër të projektit Erasmus + pwr zhvillimin e kapaciteteve pwr shkrimin e projekteve tw BE. - Kurset – trajnimet bazike dhe të avancuar për stafin akademik do të jenë të obligueshme dhe do të organizohen në fund të vitit 2019 dhe do të jenë procese të përhershme për të gjithë stafin akademik.

Objektivi specifik 5.3: Transparenca dhe llogaridhënia e vazhdueshme.

Ky objektivi ka për qëllim që të jemi sa më transparent në paraqitjen e rezultateve të punës së arritur dhe në llogaridhënie.

Afati Kohor:	2018– 2021
Aktiviteti:	Aplikimi i rregulloreve.
Statusi:	Është realizuar
Arsyetimi:	Të gjitha rregulloret e brendshme të UMIB janë bërë transparente duke u publikuar në ueb faqen e UMIB – it. Gjithashtu edhe raporti vjetor dhe raportet periodike financiare janë të publikuara duke përfshirë edhe raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit. Bazuar në Raportin e auditimit për vitin 2018 në tërësi janë aplikuar rregulloret financiare – nuk janë dhënë rekomandime

Objektivi specifik 5.4: Përmirësimi i vazhdueshëm i shërbimeve për stafin dhe studentin.

Ngritja e kapaciteteve të shërbimeve ndaj studentëve dhe të tjerëve.

